



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3226/Prot.
/3

Tiranë, më 08. 11. 2024

V E N D I M

Nr. 74 dt. 08. 11. 2024

“PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR
NË “FIZIOTERAPI” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”**

Në zbatim të nenit 3 pika 2 gërma b, 35, 38, 70, pika 3, 75 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendim nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Vendim Nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendim nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, nenit 7 pika 2, 20, 73, 75 të Statutit të UST-së, nenit 7, 48, 49, 51, 59 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr. 3184/1 Prot., datë 05.11.2024 “Propozim për miratimin e dokumentacionit për hapjen e Programit të dytë të studimit “Master Shkencor në “Fizioterapi” në FSHR” si dhe shkresën e Departamentit të Rehabilitimit nr. 3184 Prot., datë 05.11.2024 “Përcjellje për miratimin e dokumentacionit për hapjen e Masterit Shkencor në “Fizioterapi” për vitin akademik 2025-2026”, Vendimin e Rektoratit nr. 80, datë 07.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.11.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit Master Shkencor në “Fizioterapi” në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit” të UST-së, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Bordit të Administrimit për miratim, Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit për njohje, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Dokumentacioni përkatës ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

